



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/40/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokatët V.V dhe B.K për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares V.S, bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 02.12.2022 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga avokatët V.V dhe B.K ndaj gjyqtares V.S, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Avokatët V.V dhe B.K kanë ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares V.S, e pranuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datë 02.11.2022.

Me datë 08.11.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruesve.

Në ankesën e tyre avokatët V.V dhe B.K ka theksuar se, gjyqtarja V.S ka kryer shkelje të shumta por kryesore në këtë çështje është kontrabanduar kompetenca, dhe në vend se të vendosë Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e cila është gjykatë kompetente, në këtë rast është tentuar që të vendosë Gjykata Themelore në Prishtinë si gjykatë jo kompetente, dhe kjo është në kundërshtim me Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, në kundërshtim me qindra praktika të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme si dhe në kundërshtim me Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës që kanë të bëjnë me çështje identike.

Tutje, parashtruesit e ankesës kanë theksuar se, gjyqtarja e çështjes e ka lënë në fuqi për më shumë se tri vite një aktvendim për masën e përkohshme, e për të cilën paditësi ka paraqitur kundërshtim, ndërsa seanca për këtë është dashur të caktohet në afat prej 5 ditësh. Kanë shtuar se, gjyqtarja i ka caktuar seancat gjyqësore në periudha pesë ose gjashtë mujore, gjithashtu i ka caktuar seancat në gjyqësore në festë shtetërore vetëm e vetëm ta prolongon kundërligjshëm procedurën.

Tutje në ankesë parashtruesit kanë theksuar se, gjyqtarja e rastit në seancën e datës 26.10.2022 ju jep legjitimitet dy avokatëve që t'i përfaqësojnë Ndërmarrjet Shoqërore dhe atë Sh.C nga Beogradi dhe Sh.C nga Sarajeva, ndërsa sipas Ligjit për AKP-në Ndërmarrjet Shoqërore mund t'i përfaqësoj vetëm AKP.

Më tej në ankesë parashtruesit i kanë cekur rrethanat procedurale të rastit, duke shtuar se, propozimi për përsëritjen e procedurës është paraqitur nga AKP për procedurën e përfunduar SCA-09-0003, ndërsa nuk është paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës

C.nr.2023/07 të datës 09.09.2008. Kanë shtuar se propozimi për përsëritjen e procedurës asnjëherë nuk është dërguar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe kjo – sipas parashtruesve – paraqet fillimin e arbitraritetit në këtë çështje juridike.

Tutje, në ankesën e tyre parashtruesit kanë theksuar se, me datë 11.11.2014 Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme kishte nxjerrë Aktvendimin AC-II-14-0037 me të cilin kishte vendosur se DH.P.GJ.S nuk ka juridiksion lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës të paraqitur ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.2023/07 të datës 09.09.2008 duke dërguar lëndën në Gjykatën Themelore të Prishtinës për shqyrtimin e kërkesës. Kanë shtuar se, me datë 26.05.2015 Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerrë Aktvendimin C.nr.2023/2007 të datës 26.05.2015 me të cilin e kishte hedhur poshtë propozimin për përsëritjen e procedurës, si të palejueshëm. Kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës C.nr.2023/07 të datës 26.05.2015, AKP me datë 06.07.2015 ka parashtruar ankesë, ndërsa me datë 22.11.2016 DH.P.GJ.S ka nxjerr aktvendimin e saj AC-II-16-0005 me të cilin kishte vendosur se AKP nuk kishte juridiksion lidhur me ankesën e parashtruar nga AKP, dhe lënda iu është kthyer Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e ankesës.

Më tej në ankesën e tyre, parashtruesit kanë theksuar se, me datë 20.02.2019 Gjykata e Apelit kishte miratuar si të bazuara ankesat e përfaqësuesit të autorizuar të AKP-së dhe të ndërhyrësve ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2023/07 të datës 26.05.2022 e kishte prishur dhe e kishte kthyer në ri procedurë. Kanë shtuar se, me datë 24.09.2019 Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerr Aktvendimin C.nr.787/2019 me të cilin ka caktuar masën e përkohshme të sigurimit. Kanë theksuar se, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka kompetencë për të vendosur lidhur me propozimin e procedurës të paraqitur nga AKP, por kompetente është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Kanë shtuar se, gjyqtarja V.S pasi e ka pranuar lëndën nga gjyqtari H.S, seancën e ka caktuar me datë 25.05.2021 dhe seanca nuk është mbajtur me arsytim se nuk ka kushte për mbajtjen e seancës me arsyetimin se “Sh.C” me seli në Beograd nuk ka prova se është ftuar në mënyrë të rregullt, dhe në procesverbalin e kësaj seance gjyqtarja ka theksuar se është seancë e shqyrtimit përgaditor, edhe pse kishim të bëjmë me seancë për vlerësimin e kundërshtimit të kundër Aktvendimit mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurimit. Kanë shtuar se, seanca ishte shtyrë për 5 muaj ndërsa sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjyqtarja ka qenë e obliguar të vendosë në afat prej pesë ditësh nga dita e paraqitjes së kundërshtimit ndaj Aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme.

Tutje, parashtruesit e ankesës kanë theksuar se, gjyqtarja V.S seancën tjetër e cakton me datë 18.04.2022, ndërsa nga data 25.05.2021 deri me datë 18.04.2022 kanë kaluar 10 muaj e disa ditë, për më tepër seancën e datës 18.04.2022 e kishte caktuar në ditën e festës shtetërore, kurse seancën e radhës e cakton me datë 26.10.2022, pra më shumë se 6 muaj.

Kanë shtuar se, në seancën e datës 26.10.2022 gjyqtarja e kishte devijuar qëllimin e seancës dhe në vend se të vendoste për çështjen e in kompetencës fillimisht, e pastaj nëse do të mbetej kompetente të vendoste lidhur me kundërshtimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, ndërsa gjyqtarja kalon në seancë për vlerësimin e propozimit të për përsëritje të procedurës. Më tej në ankesë parashtruesit V.V dhe B.K kanë theksuar se, në seancën e datës 26.10.2022, gjykata iu jep legjitimitet ndërmarrjeve “Sh.C” nga Sarajeva dhe “Sh.C” nga Beogradi, ndërsa sipas ligjit ndërmarrjet shoqërore mund t’i përfaqësoj vetëm Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe askush tjetër.

Ndërsa, parashtruesi av. V.V shtuar se, pas një tensioni në gjykim, ka paralajmëruar përjashtimin e gjyqtares, ndërsa gjyqtarja e ndërpreu seancën dhe doli nga salla e gjykimit, pastaj bashkëpunëtorja profesionale e ka sjellë procesverbalin për nënshkrim, por para se të nënshkruante

procesverbalin, e ka lexuar me kujdes dhe aty ku fillon deklarimi i tij nuk gjen asnjë fjali të kompletuar, gabime gramatikore madje asnjë fjali e përkohshme në mënyrë konkrete. Ka theksuar se, është për t'u çuditur se procesverbali në faqen 1, 2, 3, dhe 4 është i kuptueshëm, kur kanë deklaruar pjesëmarrësit tjerë, ndërsa procesverbali në faqen 5 dhe 6 ku ka deklaruar ai është i pakuptueshëm dhe konfuz.

Në fund të ankesës, parashtruesit kanë propozuar që ndaj gjyqtarës V.S të fillohet procedura disiplinore ashtu siç përcakton ligji, sepse po prolongohet vendosja lidhur me kundërshtimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të ankesës, gjyqtarja V.S ka deklaruar se, me datë 26.10.2022, në Gjykatën Themelore në Prishtinë është mbajtur seanca lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës të paraqitur nga ndërhyrësit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Sh.C Sarajevë, B.P dhe F.B. Ka shtuar se, në seancën e mbajtur i autorizuari i paditësit Z.Z, avokati V.V ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarës në këtë rast, ku edhe është ndërprerë shqyrtimi deri në vendosjen lidhur me përjashtimin apo jo të gjyqtarës. Ka theksuar se, disa nga arsyet e paraqitura nga parashtruesit janë: 1. Kontrabandim i kompetencës nga Gjykatat e Instancave më të larta, dhe kërkesa për hapjen e konfliktit për kompetencë, e cila kërkesë është injoruar nga gjyqtarja e rastit, 2. Mos caktimi i seancës për masë të sigurisë dhe caktimi i seancës për të vendosur lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës, 3. Caktimi i seancave për periudhën 5 ose 6 mujore, 4. Caktimi i seancës në festa zyrtare etj. Ka shtuar se, asnjë pretendim i parashtruesve për shkelje disiplinore nuk qëndron. Ka theksuar se, nuk qëndron pretendimi ankimor se gjyqtarja e ka "kontrabanduar" kompetencën nga gjykatat e Instancave më të larta, për faktin se: këtë lëndë e ka marrë në punë me datë 26.08.2020, e cila lëndë paraprakisht ka qenë tek të dy gjyqtar të tjerë, Gjyqtari H.S dhe Gjyqtarja F.L. Në tej në deklaratën e saj gjyqtarja e rastit ka theksuar se, sa i përket propozimit për përsëritjen e procedurës (mjet i jashtëzakonshëm juridik) Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme me datë 11.11.2014 ka marrë Aktvendim AC-II-12-0037, dhe ka vendosur lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës, me të cilin aktvendim e ka kthyer lëndën për shqyrtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për faktin se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk ka Juridiksion lidhur me kërkesën për Përsëritjen e Procedurës ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.2023/07 të datës 09.09.2008. Gjykata Themelore në Prishtinë 15.01.2013, komplet dosjen e lëndës e ka dërguar për vendosje në Gjykatën Supreme të Kosovës, sipas Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë.

Tutje, në deklaratën e saj gjyqtarja V.S ka theksuar se, Gjykata Supreme e Kosovës me datë 11.02.2014, lëndën e ka dërguar për procedurë të mëtejshme, konkretisht për të vendosur për Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë (mjet i jashtëzakonshëm juridik) në Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke pasur parasysh faktin se Dhoma e Posaçme është kompetente për çështje që ndërlidhën me AKP-në. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, konkretisht Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ka marrë Aktvendim me numër AC-II – 14-0010 me datë 19.06.2014, me të cilin Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, e hedhë poshtë si të pa pranueshme.

Ka shtuar se, Gjykata Themelore në Prishtinë duke vepruar konform Aktvendimit të Kolegji të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ka vazhduar procedurën dhe me datë 26.05.2015, ka marrë Aktvendim me numër C.nr.2023/2007, me të cilin e ka hedhur poshtë propozimin për përsëritjen e procedurës. Përfaqësuesi i autorizuari i paditësit, nuk ka paraqitur ankesë në këtë çështje, ndërsa ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kanë paraqitur ndërhyrësit. Pas pranimit të lëndës nga Gjykata e Apelit, gjyqtari i Gjykatës së Apelit N.L, përsëri e dërgon dosjen e lëndës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për të vendosur lidhur me Ankesën e paraqitur ndaj Aktvendim me numër C.nr.2023/2007 të datës 26.05.2015. Dhoma e Posaçme e

Gjykatës Supreme, konkretisht Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme me datë 26.05.2015, merr aktvendim me të cilin thekson se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk ka Juridiksion lidhur me ankesën e paraqitur nga AKP dhe lënda i kthehet Gjykatës së Apelit në Prishtinë për shqyrtim të ankesës. Gjykata e Apelit e shqyrton ankesën e paraqitur nga AKP dhe me datë 20.02.2019, merr vendim dhe e miraton ankesën e ndërhyrësit AKP-së, dhe B.I dhe F.B, e prishë Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2023/2007 të datës 26.05.2015, dhe e kthen në ri procedurë për vendosje çështjen lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës.

Tutje, në deklaratën e saj, gjyqtarja V.S ka theksuar se, sa i përket vlerësimit të Kompetencës, është vlerësuar mjaftueshëm nga instancat më të larta të Sistemit Gjyqësor, e po ashtu vlerësimi i kompetencës vlerësohet nga gjyqtari i çështjes, ndërsa kundërshtimet lidhur me kompetencën mund të jenë bazë për paraqitje të ankesës, dhe jo si bazë për përjashtimin e gjyqtarit nga vendosja në ndonjë çështje, apo bazë për iniciimin e procedurës disiplinore.

Ka shtuar se, sa i përket çështjes së mos caktimit të seancës për masë të sigurisë dhe caktimit të seancës për të vendosur lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës, së pari gjykata vlerëson kompetencën e saj, dhe fillimisht duhet të vendoset lidhur me përsëritjen e procedurës, pastaj të shikohet çështja e masës së sigurisë. Ndërsa, sa i përket çështjes së caktimit të seancave për periudhën 5 ose 6 mujore dallim, gjyqtarja e rastit ka theksuar se, në këtë çështje Gjykata është e vetëdijshme se seancat dëgjimore duhet të caktohet brenda afatit sa më të shkurtër kohorë, mirëpo pasi kemi të bëjmë me të paditur i cili është jashtë shtetit të Kosovës, dhe komunikimi me shkresa me personat jashtë shtetit të Kosovës duhet të bëhet përmes rrugëve zyrtare dhe kjo çështje merr kohë më të gjatë, krejt kjo me qëllim të sigurimit të palëve në procedurë ose kthimin e një përgjigje konkrete nga institucionet e shtetit serb, në mënyrë që mos të ketë zvarritje të mëtutjeshme të procedurës. Ka shtuar se, konform Udhëzimit Administrativ për Procedurën e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare në çështje penale dhe civile, ku neni 4 i këtij udhëzimi përcakton afatin kohor për procedimin e kërkesave për NJN, (Ndihme Juridike Ndërkombëtare) nga Kosova për shtetet e huaja, në paragrafi 1 i këtij neni parashihet që: Gjykatat the Prokurorit e Republikës së Kosovës nuk mund të kërkojnë procedimin e kërkesave për NJN, veçanërisht ftesave për paraqitjen në seancë gjyqësore, në një afat më të shkurtër kohorë se pesë (5) muaj. Afati Kohor do të llogaritet nga data e pranimit të kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë. Kjo periudhë kohore është e nevojshme duke pasur parasysh vonesat e mundshme për procedimin e kërkesave tek autoritetet përkatëse të shteteve të huaja, përfshirë përkthimin e dokumenteve si në Republikën e Kosovës ashtu edhe në shtetin që i dërgohet.

Ndërsa, lidhur me çështjen e caktimit të seancës në festa zyrtare, gjyqtarja e V.S ka theksuar se, meqenëse seanca është caktuar paraprakisht 6 muaj para datës 18.04.2022, nuk ka pasur njohuri se dita e hënë, datë 18.04.2022, janë pashkët katolike.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dosjes së lëndës, deklaramit të gjyqtares dhe pretendimeve të parashtruesve të ankesës ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për iniciim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares V.S.

Rrjedhimisht, Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka bazë të arsyeshme për iniciimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet dhe mosveprimet e gjyqtares V.S lidhur me vlerësimin e kompetencës në lëndën C.nr.787/19 dhe moskryerjen e detyrave zyrtare me kohë.

Nga pretendimet e palës ankuese, Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate vlerëson se shkeljet e pretenduara disiplinore konsistojnë në: trajtim i pabarabartë i palëve në procedurë, moskryerje të detyrave zyrtare me kohë.

Nga shkresat e lëndës C.nr.787/19 rezulton se, me aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme AC-II-12-0058 të datës 27.09.2012 është vendosur se, ankesa e AKP-së e paraqitur ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.2023/07 i datës 09.09.2008 dhe kërkesa për masë të përkohshme hedhen poshtë si të papranueshme. Për më tepër në arsyetim të këtij aktvendimi thuhet se, "...AKP ka paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinës, në të cilën nuk ishte palë, të paditurit në procedurat pranë DHPGJS janë "Sh.C Comerc" dhe R.S, asnjëri nuk mund të jetë i paditur në pajtim me nenin 5 të LDHP, i padituri i dytë është një ndërmarrje e cila sipas AKP-së është nga Sarajeva dhe e Regjistruar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë por me degë në Prishtinë, Kosovë, kjo ndërmarrje nuk mund të konsiderohet e paditur në pajtim me nenin 5 të LDHP-së, për më tepër Aktgjykimi i Gjykatës Komunale është bërë i formës së prerë me 22 dhjetor 2010, andaj ky aktgjykim është res judicata dhe apeli është i pasafatshëm".

Për më tepër, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vëren se, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme me aktvendimin AC-II-14-0037 të datës 11.11.2014 ka vendosur që, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk ka Juridiksion lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.2023/07 të datës 09.09.2008 dhe se lënda i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë për shqyrtim të kërkesës.

Lidhur me pretendimin ankimor se, gjyqtarja V.S gabimisht ka vlerësuar se është kompetente për të vendosur për përsëritjen e procedurës, respektivisht se është duke i shkelur dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe praktikën e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarëve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur, por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore. Në këtë drejtim, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vë në pah se me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: "Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë".

Për më tepër, lidhur me vlerësimin e kompetencës në rastin konkret ka vendosur Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme në aktvendimet AC-II-12-0058 të datës 04.10.2012, AC-II-14-0010 të datës 19.06.2014, AC-II-14-0037 të datës 11.11.2014, dhe AC-II-16-0005 të datës 29.09.2016. Gjithashtu Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vëren se, Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr.3893/16 të datës 20.02.2019 e ka kthyer në rivendosje aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2023/07 të datës 26.05.2015 për Autoritetin e kësaj Gjykate paraqet mjet të konsumuar juridik në shkallë të dytë, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë i përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate, duke pasur parasysh faktet e përshkuara më lartë të argumentuara nga gjykatat e instancave më të larta, vlerëson se çështja e kompetencës në lëndën C.nr.787/19 është vlerësuar mjaftueshëm nga gjykatat e instancave më të larta. Për më tepër, gjykatat e shkallës së parë kanë obligim ligjor të zbatojnë udhëzimet procedurale të gjykatave të instancave më të larta, në rastin konkret, Gjykata Themelore e Prishtinës në lëndën C.nr.787/19 është duke vepruar konform udhëzimeve procedurale të Gjykatës së Apelit AC.nr.3893/16 të datës 20.02.2019.

Sa i përket pretendimeve ankimore se procesverbali i seancës së datës 26.10.2022, konkretisht pjesa ku ka deklaruar parashtruesi av. V.V është i palexueshëm dhe konfuz, Autoriteti i kësaj

gjkate vlerëson se në aspektin procedural, pala ka pasur të drejtë që gjatë seancës gjyqësore të paraqes kundërshtimet në procesverbal konform nenit 137 par. 2 të LPK-së, mirëpo në rastin konkret, parashtruesi nuk e ka nënshkruar procesverbalin as nuk i ka cekur kundërshtimet në procesverbal lidhur me lëshimet procedurale në mënyrë që t'i lihet hapësirë gjyqtares që jashtë seancës të vendos lidhur me kundërshtimin, ashtu siç parashihet me nenin 138 par. 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se, gjyqtarja V.S ka zvarritur procedurën duke caktuar seancat në distanca më të largëta kohore, konkretisht në periudha 5-6 mujore, Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk qëndron ky pretendim ankimor për faktin se, palët në procedurë janë jashtë shtetit të Kosovës dhe konform Udhëzimit Administrativ për Procedurën e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare në çështje penale dhe civile, ku neni 4 i këtij udhëzimi përcakton afatin kohor për procedimin e kërkesave për NJN, (Ndihme Juridike Ndërkombëtare) nga Kosova për shtetet e huaja, në paragrafi 1 i këtij neni parashihet që: “Gjykatat dhe Prokurorit e Republikës së Kosovës nuk mund të kërkojnë procedimin e kërkesave për NJN, veçanërisht ftesave për paraqitjen në seancë gjyqësore, në një afat më të shkurtër kohorë se pesë (5) muaj”. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se, gjyqtarja e rastit nuk ka vendosur lidhur me kundërshtimin ndaj masës së përkohshme, Autoriteti i kësaj gjykate vë në pah se është në kompetencë të gjyqtares së rastit për të vendosur se cilën procedurë do të fillon së pari, kundërshtimin ndaj aktvendimit për masë të përkohshme apo për propozimin lidhur më përsëritjen e procedurës, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoi se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja V.S ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
AD/GJTHPR/40/22, me datë 02.12.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë